



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:248760

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05463116

KF.nr.439/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “GNTC Group” SH.A, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Koci & Vokshi”, SH.A me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti - kundërvajtje doganore, vlerë kontesti 1,250.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit L.M., nga Shoqëria e Avokatëve “Koci & Vokshi”, dhe përfaqësuesit të autorizuar të paditurit M.K., me datë 27.02.2024 mori:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “GNTC Group” SH.A, me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET Aktvendimi nr.01.3.2.2/16117 i datës 14.10.2021, i Doganës së Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM dhe RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 05.11.2021 ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit nr.01.3.2.2/16117 të datës 14.10.2021, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe marrjes së vendimit arbitrar. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Si pas kërkesës nga seanca e kaluar për

dorëzimin e provës, përkatësisht marrëveshjes tre palëshe në mes të Gorenjes së Serbisë me Gorenje- Slloveni dhe pastaj Kosovën, në këtë seancë i dorëzojmë gjykatës faturën me nr.3635731221 të lëshuar nga Gorenje-Serbia, me seli ne Valjev, për Gorenjen në Slloveni me seli në Velenja, për shitjen e mallrave kontestues të cilët kanë numër të identifikimit 363721 sipas kësaj fature dhe që shprehimisht përcaktohet se këto mallra gëzojnë statusin preferencial. Po ashtu në vijim të kësaj i dorëzojmë gjykatës edhe faturën e lëshuar nga Gorenje Sllovenia për GNTC Kosovës me numër 3006738428, e cila po ashtu përmban të njëjta produkte sikurse fatura e lartcekur që gëzojnë statusin preferencial. Nga këto dëshmi vërtetohet se origjina e produktit rrjedh nga Serbia dhe se ekziston një marrëveshje kushtimisht tre palëshe për shitblerjen e frigoriferëve me status preferencial të cilat kanë qenë subjekt i gjobës së shqiptuar nga Dogana e Kosovës. Nga provat e dorëzuara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, përkatësisht faturat të cilat kanë dëshmuar se mallrat e kontestuar kanë origjinën nga Serbia, dhe janë importuar drejtpërdrejtë në Kosovë nga Serbia, përkatësisht faturimit Gorenjes –Sloveni, si të tilla ato gëzojnë statusin preferencial. Kundërshtimet e të paditurës për gjatë procesit gjyqësor se nuk është dëshmuar me asnjë provë se mallrat kanë origjinë nga Serbia, janë tërësisht të pa bazuara, kjo sepse dogana sipas autorizimeve të saj në rastet e tilla mund të kërkojë nga autoritete e një shteti tjetër dorëzimin e certifikatës se origjinës, të cilën nuk e ka bërë në rastin konkret, por edhe sikur ta kishte bërë është fakt notor se autoritet e Serbisë nuk i përgjigjen autoriteteve të Kosovës. Duke marrë parasysh konstatimin e gabuar të gjendje faktike e paditura njëkohësisht ka aplikuar gabimisht ligjin material, përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare CEFTA, duke konkluduar se frigoriferët me nr, të identifikimit 363721 nuk kanë origjinë nga Serbia dhe nuk gëzojnë statusin preferencial. Përfundimisht kërkojmë nga gjykata që ta aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, të anulojë aktvendimin 01.3.2.2/16117 të Doganës të datës 14.10.2021, si dhe të mbulojë shpenzimet e procedurës dhe të detyrohet Dogana e Kosovës t’ia kthejë paditësit pagesën e gjobës në shumë prej 1.250.00 €. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 17.06.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: E paditura mbetet në tërësi pranë deklarimeve në seancën

paraprake, duke potencuar edhe një herë se pala paditëse në asnjë rrethanë nuk ka mundur të ofrojë dokumente me të cilat e dëshmojnë të kundërtën e asaj se çka është cekur në vendimin kontestuese në lidhje me origjinën e mallit. Pra duke mos ofruar asnjë dokument në lidhje me pretendimet e saj për origjinën e mallit. Gjithashtu dokumentet e prezantuara sot në seancë nuk përkojnë me deklaratimet e përfaqësuesit të palës paditëse, ngase tërë kohën flitet për marrëveshjen e distribuimit të mallrave në mes të tri palëve, ndërsa neve na u është prezantuar faturat të cilat nuk kanë as një pikë ku flitet për ndonjë marrëveshje, ndërsa në fund të thënieve vetë pala paditëse deklaron se është e pamundur të sigurohet marrëveshja. E paditura sa i përket deklaratimit të palës paditëse lidhur me pranimin e lëndëve të tjera para dhe pas këtij rasti, fillimisht deklaron se dogana çdo rast e trajton veç e veç në bazë të dokumenteve të prezantuara të cilat e prezantojnë origjinën e një malli, dhe mendoj se ky deklaratimi i palës është tërësisht i pa bazuar, se edhe ashtu nuk paraqet asnjë provë dhe mendoj se gjykata nuk duhet ta merr si fakt për trajtimin e këtij rasti. Gjithashtu sa i përket rastit jemi duke trajtuar një kundërvajtje në të cilin rast janë marrë për bazë provat lidhur me rastin konkret. Bazuar në thëniet e lartcekura dhe provat e administruara e paditura i propozon gjykatës që të merre aktgjykim me të cilin e refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe e lë në fuqi aktvendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 16117/14.10.2021, aktvendimi 2021-1068 / 17.08.2021, përgjigja në padi e datës 17.06.2022, procesverbali i datës 14.10.2021, ankesa e ushtruar në Doganë nr.16117/23.08.2021, DUD-i 64339/16.08.2021, faturat nr.3006738428, nr.425/2021, nr.3635731221, Packing list nr.3635731221, autorizimi nr.148-07-483-01-365/9/2009, procesverbali për kundërvajtje doganore i datës 17.08.2021, dy fotografi të tiketave të mallit, dhe pagesa bankare e gjobës e datës 17.08.2021.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G, të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se Sektori i Kundërvajtjeve Doganore me Aktvendimin nr.03.1.7-2021-1068 të datës 17.08.2021, e ka shpallur përgjegjës këtu paditësin për kundërvajtje doganore nga neni 276 pika k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se kundër aktvendimit të lartcekur paditësi ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilin ankesë Dogana e Kosovës me datën 14.10.2021, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/16117, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 05.11.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, të ushtruar ndaj aktvendimit nr.03.1.7-2021-1068 të datës 17.08.2021 të Sektorit për kundërvajtje Doganore, si të pa bazuar. E paditura ka vlerësuar se Sektori për Kundërvajtje Doganore ka vepruar drejtë kur subjektin në procedurë e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore nga neni 276 pika k) të KDAK-së, me arsyetim se me datën 16.08.2021 në Zyrën e Brendshme Doganore është paraqitur për zhdoganim lënda me numër të DUD-it R-64339/16.08.2021, ku me anë të deklaratës në emërtimin e tretë ka deklaruar mallin “Pajisje elektroshtëpiake – Gorenje Frigorifera montues 259L në sasi prej 14 pce në vlerë prej 2,422.00 € me origjinë nga Serbia, ka liruar mallin nga taksa doganore në bazë të preferencës. Tutje ka theksuar se gjatë ekzaminimit të mallit është vërejtur se malli në ambalazhe ka mbishkrimin me origjinë nga EU, ku edhe në packing list ceket se produkti në fjalë nuk ka origjinë preferenciale të Serbisë, dhe me këtë rast ka shkaktuar shmangie nga pagesa e detyrimeve 242.00 €. Pra, ka vepruar në këtë mënyrë me qëllim që të paguaj detyrime doganore në shumë më të vogël nga ajo realja, me ç ‘rast subjekti ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 276 pika k) KDAK-së, me të cilin parashihet se *“Personi juridik apo fizik: Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale. do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (500) deri në dhjetëmijë (10.000) €. (bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr.04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-009), sipas të*

cilit për të gjitha shkeljet e parapara në nenin 276, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqind (500) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro”.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Nga aktvendimi i kontestuar shihet se ai përmban të meta të tilla, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues përmban të dhëna të pamjaftueshme sa i përket konstatimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike, lidhur me origjinën e mallit kontestues nga shteti eksportues.

Gjykata nga aktvendimi kontestues ka gjetur se Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike ngase nuk ka vlerësuar drejtë të gjitha elementet sa i përket aplikimit të nenit 276 pika k) të KDAK-së, duke mos dhënë sqarime lidhur me origjinën e mallit kontestues nga shteti eksportues, veprim ky që kishte me pas pasoj shkelje kundërvajtëse, andaj, gjykata vlerëson se e paditura në rivendosje duhet të verifikoj përmes rrugëve zyrtare origjinën e mallit nga shteti eksportues, si dhe të deklarohet lidhur me praktikën e pranimit të dokumentacionit të tillë para dhe pas të këtij rasti, ndaj subjektit të njëjtë.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipër cekura, Gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Andaj Gjykata e udhëzon të paditurën që në bazë të autorizimeve ligjore që ka me Kodin Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, të nxjerr aktvendim të bazuar në dispozita ligjore dhe sipas gjendjes së vërtetuar faktike duke marrë për bazë edhe të konstatimet dhe vlerësimet e Gjykatës si më lartë, si dhe gjithashtu në ri-procedurë e paditura të vlerësoj të gjitha elementet lidhur me përgjegjësinë kundërvajtëse të këtu paditësit në raport me veprimet apo mos veprimet e tija të ndërmarra në procedurë administrative, sepse vetëm mbi bazën e një konstatimi të drejtë të gjendjes faktike mund të vijë deri tek zbatimi i saktë i të drejtës materiale.

Në këtë drejtim Gjykata e detyron organin e paditur Doganën e Kosovës në Prishtinë, që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes. Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar-administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar-administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së

vendimit të kontestuar, andaj, e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të nenit 43, par 1 dhe 2, e 46, par 1 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.439/2022 datë 27.02.2024

Zyrtare Ligjore
Amire Jahiri

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.